



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM
DREJTORIA E PERSONELIT DHE INSPEKTIMIT

U R D H Ë R

NR. 154 DATË, 06 . 09. 2007

**PËR KRIJIMIN E NJËSISË SË PËRBASHKËT HETIMORE PËR
HETIMIN E KRIMIT EKONOMIK DHE KORRUPSIONIT**

Me synim,

- për të rritur cilësinë e hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale në luftën kundër veprave penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, si dhe;
- për të rritur dhe forcuar bashkëpunimin ndërinstytucional në këtë fushë;

Në mbështetje, të nenit 24 pika 4 e vijues të K. Pr. Penale, të nenit 8 pika 2 të ligjit nr. 8737, datë 12. 02. 2001 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe në përmbushje të angazhimeve që parashikon Memorandumi i Bashkëpunimit me Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Financave dhe Drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit, datë 22. 05. 2007 "Për krijimin e Njesisë së Përbashkët Hetimore për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit";

U R D H Ë R O J :

I. ORGANIZIMI DHE STRUKTURA ORGANIKE

1. Në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë krijohet Njësia e Përbashkët Hetimore për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit (në vijim: "Njësia e Përbashkët Hetimore").

1.2 Në Njësinë e Përbashkët Hetimore do të organizohen 7 (shtatë) ekiye.

2. Struktura organike e Njesisë së Përbashkët Hetimore, do të jetë, si më poshtë:

2.1. Drejtuesi i Njesisë së Përbashkët Hetimore (NjPH), i cili është në nivel zëvendësdrejtuesi në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë;

2.2. Prokurorë 7 (shtatë), nga një prokuror për secilin ekip;

2.3. Oficerë të Policisë Gjyqësore (opgj-juristë 7 (shtatë), nga një opgj-jurist për secilin ekip.

3. Në Njësinë e Përbashkët Hetimore të caktohen prokurorët dhe opgj-juristët më me përvojë në ndjekjen e çështjeve të krimit ekonomik dhe korrupsionit, ata që kanë marrë pjesë në kurse kualifikimi për hetimin dhe ngritjen e akuzës për rastet e krimit ekonomik dhe korrupsionit, për aq sa është e mundur ata që krahas arsimit juridik kanë dhe atë ekonomik, si dhe prokurorët magjistratë.

4. Në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, pranë Drejtorisë Kundër Krimit të Organizuar krijohet Sektori Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit.

4.1 Në përbërje të këtij sektori do të jenë 3 (tre) prokurorë të kësaj Zyre;

4.2 Në këtë sektor të caktohen prokurorët që kanë eksperiencë dhe njohuri të mira në hetimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit.

II. KOMPETENCA LËNDORE

1. Njësia e Përbashkët Hetimore do të ketë kompetencë lëndore për hetimin e veprave penale, si më poshtë:

1.1 Neni 135 - Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën;

1.2 Neni 143/a - Skemat mashtruese dhe piramidale;

1.3 Neni 144 - Mashtrimi në subvencione;

1.4 Neni 145 - Mashtrimi në sigurime;

1.5 Neni 146 - Mashtrimi në kredi;

1.6 Seksioni IV, nenet 163 deri 170/b - Veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare;

1.7 Seksioni V, nenet 171 deri 179/a - Krimet në fushën e doganave;

1.8 Seksioni VI, nenet 180 deri 182 - Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet;

1.9 Seksioni VII, nenet 183 deri 185 - Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë;

1.10 Seksioni IV, nenet 193 deri 196 - Veprat penale në fushën e falimentimit;

1.11 Neni 230/c - Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës apo profesionit;

1.12 Neni 230/ç - Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur;

1.13 Neni 230/d - Grumbullimi i fondeve për financimin e terrorizmit;

1.14 Neni 244 - Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike;

1.15 Neni 245 - Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë;

- 1.16 Neni 245/1 - Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike;
- 1.17 Neni 248 - Shpërdorimi i detyrës;
- 1.18 Neni 256 - Shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti;
- 1.19 Neni 257 - Përfitimi i paligjshëm i interesave;
- 1.20 Neni 257/a - Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike;
- 1.21 Neni 258 - Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tender apo ankande publike;
- 1.22 Neni 259 - Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike;
- 1.23 Neni 260 - Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë;
- 1.24 Neni 287 - Pastrimi i produkteve të veprës penale;
- 1.25 Neni 312 - Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit;
- 1.26 Neni 319 - Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë;
- 1.27 Neni 319/a - Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë;
- 1.28 Neni 328 - Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve;

- 2.** Kur, gjatë hetimit të veprave penale të parashikuara në pikën **II-1** të këtij urdhri, rezultojnë dyshime të arsyeshme se janë kryer vepra penale të tjera, por që nuk janë të parashikuara në këtë paragraf, Njësia e Përbashkët Hetimore do të ketë kompetencën të vazhdojë hetimin dhe të ngrejë akuzë edhe për këto vepra penale, duke zbatuar urdhërimet e neneve 79, paragrafi 1, shkronja "b" dhe 82 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastet e procedimeve të lidhura, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 306 të këtij Kodi.
- 3.** Njësia e Përbashkët Hetimore do të ketë, gjithashtu, kompetencë lëndore për të hetuar çdo vepër penale me natyrë ekonomiko-financiare që do të parashikohet nga legjislacioni i miratuar pas datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
- 4.** Duke filluar nga 10 shtator 2007, të gjitha veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal e të listuara në pikën **II-1** të këtij urdhri, do të hetohen nga Njësia e Përbashkët Hetimore. Procedimet e regjistruara përpara datës 10 shtator 2007 do të vazhdojnë të ndiqen deri në përfundim të gjykimit nga prokurorët që i kanë patur në ndjekje këto çështje që në fillim.

III. FUNKSIONIMI

- 1.** Gjashtë ekipe në përbërje të Njesisë së Përbashkët Hetimore do të ndjekin hetimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit, si dhe do të ngrenë e përfaqësojnë akuzën në gjykatë për këto vepra penale, sipas natyrës së tyre dhe kompleksitetit të hetimeve.
- 2.** Ekipi i shtatë do të funksionojë si "Ekipi për Kërkimin dhe Vlerësimin e Informacionit për Regjistrimin e Procedimeve me Iniciativë".
 - 6.1.** Ky ekip do të jetë përgjegjës për të kërkuar dhe siguruar informacion, të dhëna, apo fakte që mundësojnë regjistrimin me iniciativë të procedimeve në kompetencë të Njesisë së Përbashkët Hetimore. Për këtë qëllim, ai do të shfrytëzojë çdo të dhënë që disponojnë shërbimet përkatëse të policisë dhe ndërlidhësit e posaçëm, si dhe do të mbajë kontakte të vazhdueshme me përfaqësues të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive, të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të Inspektorateve dhe strukturave të kontrollit të brendshëm në Ministri të ndryshme, si dhe me të gjitha entet e tjera publike dhe private që mund të japin informacion, të dhëna apo fakte të dobishëm në këtë fushë. Ky ekip ka detyrimin të verifikojë informacionin e siguruar në çdo formë ligjore dhe t'i sugjerojë Drejtuesit të njesisë regjistrimin e procedimit penal.
 - 6.2.** Ndërlidhësit e posaçëm të këtij ekipi do të mbajnë lidhje të vazhdueshme me këtë ekip dhe në përputhje me ligjet përkatëse, do t'i referojnë ekipit të dhëna pa vonesë, si dhe do të zhvillojnë çdo javë takime, me qëllimin për të shkëmbyer informacion, strategji hetimi, eksperience dhe bashkëpunim operacionale, për aq sa është e mundur.
- 3.** Veprimtaria e Njesisë së Përbashkët Hetimore organizohet, drejtohet dhe Kontrollonhet nga drejtuesi i saj – zëvendës drejtuesi i Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë.
- 4.** Për çdo kallëzim penal, referim apo regjistrim kryesisht të procedimeve që lidhen me veprat penale në kompetencë të Njesisë së Përbashkët Hetimore, do të njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 48 orë, me shkrim, Sektori Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në Drejtorinë Kundër Krimit të Organizuar të kësaj Zyre.
- 5.** Drejtuesi i Njesisë së Përbashkët Hetimore, i ndihmuar nga Kancelari dhe Zyra e Regjistrimit, përgatit raporte statistikore tremujore dhe vjetore.

6.1. Ai përgjigjet për informimin çdo muaj të Sektorit Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrinë të Brendshme, Ministrinë të Financave dhe Drejtorinë të Shërbimit Informativ të Shtetit, për të dhënat e çështjeve të dërguara për gjykim.

6. Sektori Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në Drejtorinë Kundër Krimit të Organizuar i Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm ndihmon, mbështet dhe kontrollon veprimtarinë e Njesisë së Përbashkët Hetimore në ushtrimin funksioneve të saj

6.1. Prokurorët e këtij Sektori, jo më rrallë se një herë në javë, analizojnë çështjet më problematike që ndiqen nga prokurorët e Njesisë së Përbashkët Hetimore, si dhe komunikojnë rregullisht me to për të zhvilluar strategji hetimi dhe për të lehtësuar komunikimin me institucionet qendrore.

7. Çdo fund viti, Drejtuesi i Njesisë së Përbashkët Hetimore përgatit një vlerësim me shkrim për çdo anëtar të saj, duke përfshirë si prokurorët, ashtu edhe oficerët e policisë gjyqësore, vlerësim i cili nuk paragjykon procedurat e vlerësimit profesional si pas ligjit.

IV. DISA RREGULLIME ADMINISTRATIVE

1. Administrata e Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë e ndihmuar nga administrata e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm merr masa për pajisjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Njesisë së Përbashkët Hetimore me zyra, pajisje kompjuterike, mjete të tjera logjistike, automjete dhe me personelin e nevojshëm administrativë në shërbim të tyre.

2. Në vartësi të vështirësive të çështjeve dhe rezultateve pozitive në punë, Drejtuesi i Njesisë së Përbashkët Hetimore t'i propozojë Prokurorit të Përgjithshëm deri në 20 për qind shtesë page, si dhe shpërblime për prokurorët dhe opgj-të e kësaj Njësie.

V. NJOHJA, ZBATIMI, KONTROLLI DHE PËRGJEGJËSIA PËR SHKELJET

1. Me këtë urdhër të njihen oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe drejtuesit e prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë, si dhe prokurorët, drejtorët dhe Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij urdhri ngarkohen prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe drejtuesit e Njesisë së Përbashkët Hetimore dhe të Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë, si dhe drejtuesit dhe Sekretari i Përgjithshëm i kësaj Zyre.

3. Mospërbushja e detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, përbën shkelje të disiplinës në punë.

4. Urdhri nr.233, date 11. 11. 2005, "Mbi krijimin e Task Forcës për Luftën kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU